



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2510/4 prot.,

Datë.09.12.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 1225/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-44358-10-04-2022, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”, me fond limit 4,992,574 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vorë  
*Rr. “Unaza”, Vorë*

**Ankimues:** Operatori ekonomik “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK  
*Adresa: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr. 3, Pasuria e llojitnBodrum, Nr. 4/12 + 3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-44358-10-04-2022, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”, me fond limit 4,992,574 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

II.2. Në datën 24.10.2022, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 09.11.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “MURATI BA” SHPK	3,706,590	lekë	I skualifikuar
- “Martini Konstruktion & Real Estate” SHPK	3,926,352	lekë	I skualifikuar
- “GRIALD” SHPK	4,782,600	lekë	I kualifikuar

II.6. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se autoriteti kontraktor më datë 09.11.2022 ka publikuar Njoftim-Fituesin për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 02.09.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2022/2681 me nr. 2510 prot., datë 14.11.2022 e operatorit ekonomik “Martini Konstruktion & Real Estate” SHPK me objekt shfuqizim të vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si edhe formularin e publikimit me nr. 2510/2 datë 14.11.09.2022 ku kërkon shfuqizimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK

II.9. Me shkresën nr. 6538/2 prot., datë 22.11.2022 me objekt: “*Dërgohet informacion dhe vendimi shqyrtim ankesë*”, drejtuar KPP-së protokolluar me tonën me nr. 2510/3 prot., datë 25.11.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur refuzimin e ankesës. Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën si më poshtë vijon:

*“[...] **Komenti i Komisionit të Trajtimit të Ankesës:** lidhur me arsyen e skualifikimit pasi mjetet me qira nuk duhet të rezultojnë në përdorim vetjak, por në përdorim nga të tretët, vënë në dukje se bëhët fjalë për mjetet e vetdeklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8, konkretisht mjetet:*

- 1. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton, me Targë AA592JS në pronësi të “Skela Martini” e marrë me qira me nr.Rep. 1855, Kol. 753 datë 28.04.2022+amendim i kontratës me nr. Rep.104, Kol. 29, datë 11.01.2021, me kohezgatje kontratës të qirasë amendimit, dy vite nga data e nënshkrimit të Amendimit të Kontratës së Qirasë.*
- 2. Makinë Transporti të Mbeturinave Inerte m kontnier të lëvizshëm me targë AA869PB+BR4072B, në pronësi të “Salillari” shpk, e marrë me qira sipas kontratës së qirasë të gjitë periudhën e ofrimit të shërbimeve nëse shoqëria “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK shpallet fituese, për objektin e prokurimit publik me autoritetet Bashkia Vorë “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”.*

*KSHA sqaronn se operatori ekonomik në ofertën e tij në një procedurë prokurimi duhet të marrë të gjitha masat për përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor në vërtetimin e fakteve të vetdeklaruar, kështu që në rastin objekt shqyrtimi OE “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK duhet të kishte marrë masat që të ishin bërë ndryshimet përkatëse në lejen e qarkullimit të autobjeteve me targë AA592JS dhe AA869PB+BR4072B dhe të ishte specifikuar përdorimi ndaj të tretëve.*

#### VENDOSI

*Refuzimin e ankesës më nr. 6516 prot., datë 15.11.2022 në procedurën e prokurimit publik me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”, nga operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK. [...].*

II.11. Në një rast të ngjashëm, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresave me nr. 1904/5 prot., datë 27.09.2022 me objekt “Kërkesë për informacion” i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe shkresës me nr. 1904/6 prot., datë 27.09.2022 me objekt “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit

Rrugor, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion këtyre institucioneve, si më poshtë vijon:

*“[...] Në kuadër të shqyrtimit të një ankese të paraqitur për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga institucioni juaj. Konkretisht: Në lidhje me mjetet e marra me qira nga peratorët ekonomik të cilët marrin pjesë në një procedurë prokurimi, a është i domosdoshëm ndryshimi i destinacionit dhe përdorimit të mjetit në lejen e qarkullimit, nga përdorim vetjak në përdorim për të tretët, në momentin që këto mjete merren me qira, me antë të kontratës së qirasë?*

*Nëse po, në cilin moment duhet bërë ky ndryshim, para lidhjes së kontratës së qirasë apo pas lidhjes së saj midis palëve të interesuara? [...]”*

II.12. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1904/6 prot., datë 27.09.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, me shkresën nr. 22383/1 prot., datë 04.10.2022, me objekt “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1904/7 prot., datë 06.10.2022 Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor informon KPP-në se:

*“[...] Në zbatim të nenit 93, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “Formalitetet për ndryshimin e pronësisë së automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove dhe për ndryshimin e vendbanimit të pronarit”, parashikohet se:*

*“Në rast ndryshimi pronësie të mjeteve rrugore ose në rastin kur u jepen në përdorim të tjerëve apo kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, personi i interesuar, brenda 30 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, paraqitet pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera”.*

*Mbasi kryhet regjistrimi i ndryshimit të pronësisë, lëshohet leja e re e qarkullimit në emër të pronarit, si dhe qirramarrësit të mjetit.*

*Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, parashikohet në nenin 81 të Kodit Rrugor, ku përcaktohet se destinacioni i mjetit është në varësi të karakteristikave teknike të mjetit (transport njerëzish, transport mallrash, etj.), ndërsa përdorimi i mjetit është shfrytëzimi i tij ekonomik, i cili mund të caktohet për përdorim vetjak ose për të tretët. Pra përdorimi i mjetit mund të jetë për vetë subjektin ose për të tretët, për rastet kur në objektin e veprimtarisë së QKB-së parashikohet ky përdorim.*

*Për sa më sipër, evidentimi i qiramarrësit në lejen e re të qarkullimit bëhet pasi të jetë nënshkruar kontrata e qirasë.[...]”*

II.13. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1904/5 prot., datë 27.09.2022, me objekt “Kërkesë për informacion”, me shkresën nr. 61/38 prot., datë 20.10.2022 me objekt “Kthim përgjigje shkreses tuaj nr. 1904/5, datë 27.09.2022”, protokolluar me tonën me nr. 1904/8 prot., datë 24.10.2022 Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit informon KPP-në se:

*“Në përgjigje të shkresës tuaj, ku kërkohet informacion mbi mënyrën se si veprohet me mjetet e marra me qira, nëpërmjet një procedure prokurimi publik, konkretisht për kryerjen e ndryshimeve në lejen e qarkullimit nga “mjete për përdorim vetjak” në “mjete për përdorim nga të tretët”, sqarojmë se:*

*Aktualisht, Policia e Shtetit në kontratat që harton në kuadër të procedurave të prokurimit me objekt “marrje me qira të mjeteve”, parashikon qartësisht destinacionin e mjetit (mjet që do të*

shërbejë për përdorim nga Policia e Shtetit), palët dhe kushtet për secilën palë, si rezultat nuk lind nevoja e hartimit të ndryshimeve në lejen e qarkullimit të mjetit.”

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues si edhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor:

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK lidhur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me pretendimin se:

“[...]Parashtrojmë si më poshtë pretendimet tona... Në lidhje me kriterin **2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Makine transporti te mbeturinave inerte me kontenier te levizshem. E shoqeruar me një konteniere te cilet do te stacionohen ne objekte.	në pronësi ose me qira	Copë 1

#### Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë:

- a) *Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), si edhe certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi e cila duhet të figurojë për përdorim ndaj të tretëve), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(te vlefshme),si edhe certifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.*
- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK*

Në formuularin përmbledhës së vetdeklarimit sipas shtojcës nr. 8 ne kemi deklaruar: Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton, me Targë AA592JS në pronësi të “Skela Martini” e marrë me qira me nr.Rep. 1855, Kol. 753 datë 28.04.2022+shtesë e konkratës me nr. Rep.104, Kol.

29. Në dokumentacionin bashkëlidhur kontratës gjendet certifikatë e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, siguracion, certifikatë kontroolli teknik, licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit nr. 006/2 datë 06.02.2020 në emër të shoqërisë “Skela Martini” shpk si dhe certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit për mjetin me targë AA592JS lëshuar nga Bashkia Kamëz. Nggga dokumenti i paraqitur konfirmohet fakti se vetë shoqëria qiradhënëse disponon licencën përkatëse+certifikatën për këtë mjet nën emërtimin “Transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.

Në formularin përmbledhës së vetdeklarimit shoqëria ka paraqitur kontratë mjetet me targë AA869PB+BR4072B sipas kontratës së qirasë Rep. 5359, kol. 1414, datë 20.10.2022 me shoqërinë “Salillari” shpk- me afat deri në përfundim të punimeve nëse shhoqëria do të shpallej fituese. Në vijim të arsyetimit më lat informojmë se jemi brenda afatit 30 ditor për të pasqyruar ndryshimet përkatëse në lejen e qarkullimit të mjetit, si dhe në licencën e transportit të mjetit... [...]”

III.1.1. Me shkresën nr. 6538/2 prot., datë 22.11.2022 me objekt: “Dërgohet informacion dhe vendimi shqyrtim ankese”, drejtuar KPP-së protokolluar me tonën me nr. 2510/3 prot., datë 25.11.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, në kthimin e përgjigjes lidhur me trajtimin e këtij pretendimi është shprehur se:

“[...] **Komenti i Komisionit të Trajtitimit të Ankesës:** lidhur me arsyen e skualifikimit pasi mjetet me qira nuk duhet të rezultojnë në përdorim vetjak, por në përdorim nga të tretët, vënë në dukje se bëhet fjalë për mjetet e vetdeklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8, konkretisht mjetet:

1. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton, me Targë AA592JS në pronësi të “Skela Martini” e marrë me qira me nr.Rep. 1855, Kol. 753 datë 28.04.2022+amendim i kontratës me nr. Rep.104, Kol. 29, datë 11.01.2021, me kohezgjatje kontratëstë qirasë amendimit, dy vite nga data e nënshkrimit të Amendimit të Kontratës së Qirasë.
2. Makinë Transporti të Mbeturinave Inerte m kontnier të lëvizshëm me targë AA869PB+BR4072B, në pronësi të “Salillari” shpk, e marrë me qira sipas kontratës së qirasë të gjitë periudhën e ofrimit të shërbimeve nëse shoqëria “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK shpallet fituese, për objektin e prokurimit publik me autoritetet Bashkia Vorë “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe’.

KSHA sqaronn se operatori ekonomik në ofertën e tij në një procedurë prokurimi duhet të marrë të gjitha masat për përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor në vërtetimin e fakteve të vetdeklaruar, kështu që në rastin objekt shqyrtimi OE “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK duhet të kishte marrë masat që të ishin bërë ndryshimet përkatëse në lejen e qarkullimit të autobjeteve me targë AA592JS dhe AA869PB+BR4072B dhe të ishte specifikuar përdorimi ndaj të tretëve.

III.1.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1

2	Makine transporti te mbeturinave inerte me kontenier te levizshem. E shoqeruar me një konteniere te cilet do te stacionohen ne objekte.	në pronësi ose me qira	Copë 1
---	---	------------------------	--------

**Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë:**

- a) *Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), si edhe certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi e cila duhet të figurojë për përdorim ndaj të tretëve), plus certifikaten e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit,(te vlefshme),si edhe certifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.*
- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) rezulton, se operatori ekonomik “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK në fazën e dorëzimit të ofertave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, ka dorëzuar dokumentet si më poshtë:

1. Shtojca 8 “Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit”.

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa  mjetit	Nr. Lejes qarkullimit  të mjetit	Nr. Shasisë  Sä mjetit	Nr, Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)

IXamion Vetshkarkues me kap mbajtes mbi 5 ton	AA592JS	TRF1459014	ËDB6520201K160919	Rep.18S5 ,Kol.753 + Shtesa e Kontrates Rep.104 Kol.29	Dt28.04.2020+ shtesa e kontrates Dt1L01.2021-11.01.2023
2.Makine Transporti te mbeturinave inerte me kontenier te levizshem e shoqeruar me nje kontenier te cilet stacionohen ne objekt	AA869B+BR4072B	TRDA5873416+BROOO9272	ËDB9342411L317908+SFL1084	Rep,S359	Dt.20.10.2022-Perfundim te punimeve ne objekt

III.1.3. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.5. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*



- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

- 2. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.6. Në nenin 39 pika 4 dhe pika 6/d “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.7. Në nenin 88 pika 2 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;

ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe

iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.”

III.1.8. Referuar kriterit të vendosur në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 KPP gjykon se operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK me dokumentacionit e dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) provon se disponon dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e këtij kriteri. Dokumentacioni i ngarkuar në SPE, Formulari i Vetdeklarimit sipas shtojcës 8, Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton, me Targë AA592JS në pronësi të “Skela Martini” e marrë me qira me nr.Rep. 1855, Kol. 753 datë 28.04.2022+amendim i kontratës me nr. Rep.104, Kol. 29, datë 11.01.2021, me kohezgjatje kontratëstë qirasë amendimit, dy vite nga data e nënshkrimit të Amendimit të Kontratës së Qirasë. Makinë Transporti të Mbeturinave Inerte me kontnier të lëvizshëm me targë AA869PB+BR4072B, në pronësi të “Salillari” shpk, e marrë me qira sipas kontratës së qirasë të gjtë periudhën e ofrimit të shërbimeve nëse shoqëria “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, është në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.3.5 të dokumenteve të tenderit, ku është kërkuar [...]Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi e cila duhet të figurojë për përdorim ndaj të tretëve), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(te vlefshme), si edhe certifikata për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.[...]. Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim shqyrtimin e ankimit i është referuar përgjigjes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit e cila ka informon KPP-në për një rast të ngjashëm që lidhet drejtpërdrejtë me objektin e ankesës dhe arsyet e skualifikimit të OE ankimues se:“Në përgjigje të shkresës tuaj, ku kërkohet informacion mbi mënyrën se si veprohet me mjetet e marra me qira, nëpërmjet një procedure prokurimi publik, konkretisht për kryerjen e ndryshimeve në lejen e qarkullimit nga “mjete për përdorim vetjak” në “mjete për përdorim nga të tretë”, sqarojmë se: Aktualisht, Policia e Shtetit në kontratat që harton në kuadër të procedurave të prokurimit me objekt “marrje me qira të mjeteve”, parashikon qartësisht destinacionin e mjetit (mjet që do të shërbejë për përdorim nga Policia e Shtetit), palët dhe kushtet për secilën palë, si rezultat nuk lind nevoja e hartimit të ndryshimeve në lejen e qarkullimit të mjetit.” Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Dorëzimi nga operatori ekonomik ofertues të dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi e cila duhet të figurojë për përdorim ndaj të tretëve për mjetet e marra me qira **nuk cënon disponueshmërinë e mjeteve** fakt i cili është shumë i rëndësishëm për autoritetin kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik duke pasur në vëmendje qëllimin e ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” vlerëson se ndryshimet përkatëse në lejen e qarkullimit për mjetet të cilat operatori ekonomik ofertues dhe në rastin konkret operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, nuk cënojnë dhe nuk i shqërbejnë procedurës së prokurimit në tërësi.

Operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK referuar dokumentacionin të paraqitur në (SPE), ka përmbushur kriterin e përcaktuar nga ana e autoriteti kontraktor pasi vetdeklarimi dhe kontratat e dorëzuara janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues nëpërmjet dokumentacionin të paraqitur disponon Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton, me Targë AA592JS në pronësi të “Skela Martini” e marrë me qira me nr.Rep. 1855, Kol. 753 datë 28.04.2022+amendim i kontratës me nr. Rep.104, Kol. 29, datë 11.01.2021, me kohezgjatje kontratëstë qirasë amendimit, dy vite nga data e nënshkrimit të Amendimit të Kontratës së Qirasë.

*Makinë Transporti të Mbeturinave Inerte me kontnier të lëvizshëm me targë AA869PB+BR4072B, në pronësi të “Salillari” shpk, e marrë me qira sipas kontratës së qirasë të gjatë periudhën e ofrimit të shërbimeve nëse shoqëria “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK, të cilat janë të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës ka përmbushur kriterin e përcaktuar. Për këto arsye Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK e përmbush këtë kriter të kërkuar në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi lidhur me disponimin e mjeteve.*

III.1.9. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Martini Konstruksion & Real Estate*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-44358-10-04-2022, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”, me fond limit 4,992,574 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Martini Konstruksion & Real Estate” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

